



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.857 Prot

Pustec më 13.06.2025

RAPORT PËRMBLEDHËS MBI ZHVILLIMIN E KONSULTIMIT PUBLIK

Mbledhja e rekomandimeve për prioritetet e komunitetit për draftin e parë të projekt buxhetin afatmesëm 2026 – 2028

Konsultimi publik u realizua në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në lidhje me nevojat e komunitetit për mbledhjen e rekomandimeve për prioritetet e komunitetit për draftin e parë të projekt buxhetin afatmesëm dhe përmirësimin e shërbimeve publike pranë sekretarit të këshillit bashkiak.

Konsultimi publik u realizua sipas kalendarit të mëposhtëm

	Vendi	Ora	Data
1	Pustec Salla e mbledhjeve të këshillit	11:00	13.06.2025

Banorët kanë patur mundësi të konsultojnë dokumentin në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e mëposhtëm:

<https://heyzine.com/flip-book/2c009fe9a2.html>

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë dhe e këshillit bashkiak: Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Përfaqësues nga ekzekutivi, përgj. i shërbimeve publike, Koordinator i përgj. i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, Zyra e Financës, tatim- taksave të bashkisë,

- **Nga komuniteti:** Banorët nga komuniteti, kryetarët e fshatrave, përfaqësues nga institucionet.

-**Forma e konsultimeve :** Takim publik

Qëllimi i këshillimit publik: për prioritetet e komunitetit për draftin e parë të projekt buxhetin afatmesëm 2026 – 2028

Përshkrimi i çështjeve që trajton projekt buxheti afatmesëm dhe buxheti vjetor

Miratimi i projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike

shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për mënyrën se si janë përdorur fondet gjatë vitit 2024, si dhe sfidat, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe listën me shërbime / funksioneve nga e cila komuniteti për zgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme.

DËGJESË PUBLIKE PUSTEC

Numri i pjesëmarrësve 15 (pesëmbëdhjetë)

Pjesëmarës nga administrata: kryetari i bashkisë z.Pali Kolefski, nënkryetari i bashkisë z.Atanas Plloca, specialist i finacës znj.Elena Argjiri, përgjegjës i tatim taksave z.Qiro Thanas, përgjegjës i shërbimeve, drejtori i shkollës z.Trajan Vangjelofski

Disa nga pjesëmarësit që morën fjalën: S.Tërpo, Trajan Vangjelofski, .

SYGJERIMET E DHËNA NGA KOMUNITETI

- Pllaka për shtrimin e trotuareve
- Rregullimi dhe pastrimi i vijës liqenore
- Shtresë asfaltimi aksi Pustec-Lajthizë
- Vendosja e llampave ku ka probleme
- Pastrimi i shpeshtë i plehrave dhe barishteve në disa vende
- Hapja dhe pastrimi i shtigjeme që frekuentohen nga turistët
- Funksionimi i gjobave për hedhjen e plehrave në vende të pacaktuara dhe për personat që i lejojnë kafshët gjatë sezonit veror nëpër fshat
- Pastrimi i trotuareve nga barishtet
- Krijimi i një qendre multifunkionale për promovimin e vlerave kulturore
- Autobuzi të kalojë një herë në javë në fshat
- Heqja e inerteve anës rrugëve
- Rregullimi i cesmës kryesore të fshatit
- Riparimi i govatës së ujit të qendër të fshatit
- Cakullimi i rrugës (kisha-qendrën e fshatit)
- Kënd sportiv dhe mjete për fëmijët
- Ndërrimi i shtyllës së tensionit të lartë tek Q.Pecoj dhe A.Simon
- Riparimi i disa mureve në brenda fshatit
- Hapja e rrugës për këmbësorët tek Manastiri Shën Marena
- Problem me bagëtitë e fshatit
- Cakullimi i gropave nëpër rrugët e fshatit

